

Shtypi komunist si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin totalitar shqiptar 1960-1970

*PhD Cand. Sokol Paja**

Abstrakt

Në regjimin totalitar shqiptar shtypi i shkruar komunist pati një rol të jashtëzakonshëm nëpropagandën ateiste përgjatë regjimit totalitar shqiptar 1945-1990. Mediat në Shqipërinë totalitare kthehen ne sherbim total të shtetit totalitar. Mediat transmetojnë ato informacione dhe të dhëna që janë në përputhje me parimet ideologjike dhe politike të partisë-shtet. Pushteti, mediat e kohës dhe publiku konceptohen dhe funksionojnë si e njëjta gjë. Propaganda ateiste e sistemit komunist kishte një rëndësi të veçantë për bindjen e ndërgjegjësimit e masave në luftën e proletariatit për triumfin e revolucionit proletar dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit në Shqipëri ku media pa dyshim dha rolin e saj specifik.Në këtë punim do të mësojmë mjetet dhe organizimin e propagandës ateiste në regjimin komunist në Shqipëri. Do të merren në shqyrtim artikuj me karakter të propagandës ateiste në shtypin e shkruar si gazeta : “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Zëri i Popullit” etj. Cili ishte roli i medias së shkruar? Qëllimi i vërtetë i propagandës ateiste? Cila ishte lidhja e pashmnagshme mes pushtetit, medias dhe propagandës? Partia komuniste shqiptare si parti marksiste-leniniste përgjatë gjithë veprimtarisë së ushtrimit të propagandës kërkonte me çdo kusht që njeriun ta ndryshonte jo vetëm në mënyrën dhe në stilin e jetës por ndikonte edhe psikologjikisht. Në propagandën ateiste feja barazohej me mënyrën e vjetër dhe borgjeze e jetesës, doket e zakonet prapanike dhe, veçanërisht, ideologjia fetare sipas propagandës ateiste kishte helmuar ndërgjegjen e njerëzve, duke hyrë thellë në jetën e tyre të përditshme, duke i zhytur në errësirën e padijes. Informacioni që përcillte propaganda në çdo qelizë të shoqërisë socialiste sidomos në qendar te punës dhe në organizatat-bazë të partisë përfshinte të gjitha aktivitetet politike, ideologjike, ekonomike, shoqërore, arsimore, kulturore të sistemit komunist shqiptar.

Fjalët kyçe: *Media, Propagandë, Ateizëm, Totalitarizëm, Komunizëm*

* Universiteti “Aleksandër Xhuvani” – Elbasan, Email: kolipaja@yahoo.com

Hyrje

Media totalitare në shërbim të pushtetit

Mediat në Shqipërinë totalitare transmetojnë ato informacione dhe të dhëna që janë në përputhje me parimet ideologjike dhe politike të Partisë dhe drejtuesit të Partisë-shtet. Pushteti, mediat e kohës dhe publiku konceptohen dhe funksionojnë si e njëjta gjë, pasi shteti kontrollonte, drejtonte dhe menaxhonte gjithcka. Detyra e medias në regjimin totalitar shqiptar ishte në organizimin dhe mobilizimin e masave me qëllim mbrojtjen dhe ndërtimin socialist të shqipërisë. Shtypi i shkruar komunist kthehet në propagandist kolektiv, agjikator kolektiv dhe organizator kolektiv. Sipas Hannah Arendt totalitarizmi promovon izolimin ekstrem dhe paranojën. Në regjimet totalitare, media, është e shtypur dhe vetëm propaganda promovohet, kështu që njerëzit izolohen. Propaganda e përvçjellë përmes medias kërkon të dekurajojë çdo formë të menduarit të lirë apo veprim spontan politik që mund të luftojë kundër tij.

Nëndarjet e shtypit të shkruar komunist

Nëndarjet e shtypit të shkruar në periudhën komuniste sipas Artan Fugës janë: Sipas kriterit të vendodhjes së tyre gjeografike: Shtypi qendror, i përfaqësuar nga 8 gazeta: "Zëri i Popullit", "Bashkimi", "Zëri i Rinisë", "Puna", "Mësuesi", "Drita", "Luftëtari", "Sport'i Popullor" dhe shtypi lokal me 27 tituj gazetash gjithsej, ndër të cilat 18 botohen në rrethet e Jugut dhe 9 gazeta në ato të Veriut. Sipas Artan Fugës, nëndarje tjetër e shtypit të shkruar në periudhën komuniste ishte sipas kriterit të frekuencës kohore të botimit ku kemi shtypi i përditshëm, ku më përfaqësueset janë gazeta: "Zëri i Popullit" dhe "Bashkimi". "Zëri i Popullit" nuk botohet të hënave, ndërsa gazeta Bashkimi nuk del ditën e diel, shtypi javor, ku hyjnë gazetat që botohen dy ose tri herë në javë. Nëndarja tjetër, nënvizon Fuga, ishte sipas kriterit të varësisë nga qendra të ndryshme pushteti ku kemi media të Partisë, ku hyjnë "Zëri i Popullit", si organ qendror, si dhe gazetat lokale në dispozicion të komiteteve të Partisë së rretheve, media të organizatave qendrore të masave: Fronti Demokratik-

“Bashkimi”; Bashkimi i Rinisë-“Rinia”; Bashkimet Profesionale – “Puna”, media të institucioneve administrative dhe shtetërore, si për shembull gazeta “Luftëtari” e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore; “Mësuesi” e Ministrisë së Arsimit etj. Sipas kriterit të t’ipit të përmbajtjes mediat në regjimin totalitar, sipas Artan Fugës, ndaheshin në media me përmbajtje të orientuar drejt një publiku të përfaqësuar prej shtresave të caktuara të shoqërisë (publik i specifikuar), për shembull, drejtuar fëmijëve: “Yllkat”, “Fatosi”, “Pionieri”, “Horizont’i” etj, me përmbajtje temat’ike mbi fusha të caktuara të kulturës, letërsisë dhe edukimit, si për shembull: “Sport’i Popullor”, “Mësuesi”, “Drita”, “Nëntori” etj, me përmbajtje të drejtpërdrejtë politike, sikurse janë gazetatat që kemi përmendur apo edhe revista politiko-shoqërore, si “Rruga e Partisë”, “Studime Politike-Shoqërore”, me orient’im shkencor dhe kulturor, ku bëjnë pjesë kryesisht revistat që i quajnë shkencore, sidomos ato të disa prej institucioneve kryesore kërkimore të vendit. Sipas kriterit të gjuhës së përdorur në mediat komuniste, sipas Artan Fugës, shtypi ndahej në: Shtypi i shkruar në gjuhën shqipe, shtypi i shkruar në gjuhë të huaj. Këtu bëjnë pjesë gazetatat drejtuar minoritetit grek në Shqipëri, sikurse janë: “Laiko Vima” dhe “Logotehniko Laiko Vima”. “Në një shoqëri totalitare, mënyrat e leximit të shtypit, veç një natyre individuale, ushtrohet edhe leximi i organizuar, herë-herë edhe i detyruar”¹.

Tiparet kryesore të medias komuniste

Tiparet kryesore të medias komuniste sipas Schamm janë: Komunikimet me masën janë përdorur si instrument i shtetit dhe i Partisë, janë të integruar ngushtë me instrumentet e tjerë të pushtetit shtetëror dhe ndikimit partiak, janë përdorur si instrument të njësisë brenda shtetit dhe të partisë, janë përdorur si instrument i shtetit dhe Partisë “zbuluese”, janë përdorur pothuajse veçanerisht si instrument të propagandës dhe agjitacionit. Shtypi komunist ishte i bashkuar ideologjikisht dhe politikisht i orkestruar në përgjigje direkt ndaj urdhërave politike që vinin nga Komiteti Qëndror. Artan Fuga rendit

¹ Fuga, Artan, Monolog, faqe 71, Dudaj, Tiranë, 2010

tri formave kryesore të leximit të shtypit në diktaturë: Leximi kolektiv ku për shkak të analfabetizmit të lartë, organizmat e larta Partiake këshillonin që njerëzve t'u lexohej shtypi nga ana e veprimtarëve shoqërorë. Mënyra e dytë e leximit të shtypit sipas Fugës ishte: Leximi i shtypit në radio, ku çdo ditë herët në mëngjes në emisionet e mëngjesit ishte rit tradicional leximi i pasqyrës së shtypi të ditës. Mënyra e tretë e leximit të shtypit në komunizëm ishte: Leximi i shtypit në stenda, ku në vende të caktuara të territorit të çdo ndërmarrjeje, kooperativave bujqësore apo institucioneve, si dhe në stacione treni, autobusësh, hyrje spitalesh apo në vende të tjera publike ku gjeje stenda ku ishte i afishuar shtypi i ditës. Në regjimin totalitar shqiptar "shtypi, mediat në përgjithësi, sikurse dhe sektorë të tjerë, si arsimit e kultura, konsiderohen si pjesë përbërëse e sistemit të propagandës së Partisë në fuqi dhe vendosen nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Partisë"². Në regjimin totalitar shqiptar mediat ishin totalisht të varura dhe të kontrolluara nga puShteti i kohës. Mediat kontrolloheshin rreptësisht nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, sekretari i komitetit qendror të Partisë për propagandën, shefi i sektorit të shtypit apo drejtori agjitacion-propagandës. Në regjimin totalitar shqiptar "sekretari për propagandën është personi që i drejton në përgjithësi dhe konkretisht në linjë Partiake fushat e arsimit, kulturës, shkencës dhe shtypit. Veprimtaria e mediave është vetëm njëra nga fushat që ai mbulon nga afër"³ funksioni i sekretarit për propagandën ishte transmetimi i urdhrave e porosive që vijnë nga drejtuesit e pushtetit politik. Media në regjimin totalitar varet nga grupi i ngushtë i njerëzve që drejton partinë dhe Shtetin me dorë të hekurt. Drejtuesit e sistemit totalitar nëpërmjet medias që vetë kontrollojnë, ata realizojnë propagandën sipas specifikave dhe nevojave të Partisë-shtet dhe teçojnë në publik atë informacion që vetë dëshirojnë. "Shtypi i vendit ishte qeveritar, kundërshtimi nuk lejohej, debate ishte i rrezikshëm e dialogu po vdiste, i zëvendësuar, dalëngadalë, nga fjalimet e gjata e monologët monotonë"⁴.

² Fuga, Artan, Monolog, faqe 80, Dudaj, Tiranë, 2010

³ Fuga, Artan, Monolog, faqe 86, Dudaj, Tiranë, 2010

⁴ Repishti, Sami, Nën hijen e Rozafës, faqe 111, Onufri, Tiranë 2004

Kryeredaktorët e gazetave, përgjegjësit e redaksive dhe drejtuesit e mediave audiovizive ishin nën komandën dhe jepni llogari herë pas here para sekretarit për propagandën i cili orkestronte gjithçka në korpusin mediatik totalitar. Në median komuniste “Sistemi informativ i pushtetit nuk merr, nuk perception, nuk përthith, por vetëm shpërndan, jep, transmeton. Ai kap vetëm jehonën e pandryshuar të asaj që ka transmetuar po vetë. Merr nga bota e nga realiteti vetëm ato informacione që vijnë në përputhje me strukturën e ideve të tij, me ideologjinë e tij, me bindjet e tij politike”⁵.

Funksioni i medias komuniste

Agjenda e shtypit dhe e mediave totalitare përcaktohet nga pushteti komunist në varësi dhe në shërbim të propagandës së shtetit. Sipas Artan Fugës mediat në komunizëm ishin: “*Organizatore kolektive të masave*” pasi shërbenin si instrumente të përçimit të direktivave, urdhrave, sloganeve nga maja e pushtetit te masat popullore. Mediat në komunizëm ishin “*Arkitekthe të mendimit kolektiv*” ku media komuniste reformon dhe adapton politikën e ditës sipas interesave politike të kohës. Dhe funksioni i tretë i medias komuniste ishin “*Tribuna të mendimit popullor*” ku pushteti ka nevojë ta ulë rolin e gazetarëve, t’i mbajë ata nën tryshninë e korespondentëve vullnetarë dhe duke manipuluar turmat, që të riformulojë radhët e elitave politike që zotërojnë pushtetin apo e ushtrojnë atë nga qendra në bazë”⁶. Në shtyp transmetohen ato informacione dhe ato mesazhe që mbështesin pushtetin popullor. Në mediat komuniste “revoltat janë të censuruara. Dëshpërimi kolektiv është i censuruar. Shprehja e interesit personal është e censuruar. Mungesat në treg janë të censuruara. Krimi është i censuruar. Jeta në burgje dhe në kampe përqëndrimi është e censuruar. Liritë politike në Perëndim janë të censuruara”⁷, ku pushteti dhe media janë një, nëpërmjet medias pushteti transmeton lajmet që vetë konsumon. Strukturat ideologjike

⁵ Fuga, Artan, Monolog, faqe 98, Dudaj, Tiranë, 2010

⁶ Fuga, Artan, Monolog, faqe 126, Dudaj, Tiranë, 2010

⁷ Fuga, Artan, Monolog, faqe 127, Dudaj, Tiranë, 2010

të pushtetit që kontrollon median, i detyron këto të fundit të ideologjizojnë politikisht masat e punonjëse dhe të përkrahin çdo nismë apo revolucion nën dirigjimin e Partisë-shtet ku “Gazetari nuk është veçse ilustruesi i ideve dhe politikave të Partisë në fuqi”⁸. Mediat në komunizëm sipas Artan Fugës i ngjajnë një subjekt’i të stërmadh, që gjatë gjithë kohës komunikon vetëm me veten e tij, domethënë me pushtetin që e zotëron atë, ndodhet kështu brenda një procesi monologu aut’ist. “Monolog-narcizëm institucional-autizëm kolektiv”⁹, sipas Artan Fugës, janë tri karakteristikat brenda të cilave mediat zyrtare realizojnë komunikimin me publikun. Fuga deklaron se gazetari në median komuniste duhet që të nisët nga redaksia për në terren me një mendim në kokë dhe të kthehet nga terreni në redaksi po me të njëjtin mendim me të cilin u nis. Kudo që të shkojë, gazetari do të gjejë njerëz që punojnë për të realizuar direktivën e Partisë në pushtet. Sipas Fugës gazetari në median komuniste nuk mund të dalë kurrsesi jashtë alternativave, opinioneve dhe direktivave zyrtare ku pushteti i kohës kishte vendosur kufij dhe asnjë gazetar nuk mund t’i kapërcejë ata për t’u shprehur në median e kohës. Gazetari në median totalitare, sipas Artan Fugës, ndodhet midis kufijve politikë që censura ideologjike vendos zyrtarisht për shkrimet dhe emisionet, si dhe përmbajtjen konkrete të refleksioneve dhe analizave që zhvillohen në to.

Ideologjia e mediave shqiptare në komunizëm

Partia komuniste që drejtonte shtetin kishte në dorë të gjitha mekanizmat e pushtetit, përdor shtypin e shkruar kryesisht dhe median në tërësi që të sqarojë vendime e veprime të caktuara politike apo ideologjike. “Mediat dhe propaganda zyrtare e pushtetit funksionon kështu brenda ideologjisë staliniste, mbështetur në gnoseologjinë esencialiste dhe brendashkruar një metalogjike simetrike, “antithetiste”, pra që e përjashton kundërshtarin, po aq sa

⁸ Fuga, Artan, Monolog, faqe 149, Dudaj, Tiranë, 2010

⁹ Fuga, Artan, Monolog, faqe 129, Dudaj, Tiranë, 2010

edhe kundërshtari e përjashtoi atë"¹⁰. Ideologjia e mediave shqiptare në komunizëm është ideologjia zyrtare e pushtetit që kontrollon gjithçka brenda regjimit totalitar që kishte ndërtuar, ku media padyshim kishte një rol specifik. "Shtypi ishte droga e cilësisë së lartë. Shtypi ish ndihmësi më besnik i Partisë, aty nuk lejohej asnjë shmangje, asnjë devijim. Gazetat dhe revistat ishin të pakta. Shtypin diktatura e përdorte si një plastikë për të fshehur fytyrën e saj"¹¹. Opinioni publik në socializëm sipas Maks Velos quhej klasa e gazetarëve të pregatitur nga Partia ku opinion mund të kish vetëm diktatori, ai përfaqësonte edhe opinionin publik. Diktatori Enver Hoxha e quan gazetën "Bashkimi" si një mjet shumë të rëndësishëm të shtypit të kohës duke i veshur kësaj të fundit meritat kryesore në edukimin e masave me frymën e patriotizmit e internacionalizmit proletar dhe ka meritë sipas udhëheqësit të Partisë-shtet në çelikesjen e unitetit të popullit shqiptar rreth Partisë, mobilizimin e popullit për ndërtimin e socializmit dhe për demaskimin e armiqve. Hoxha në letrën e falënderimit për redaksinë e "Bashkimit", nuk harron të theksojë që gazeta "Bashkimi" do të rritë edhe më tej rolin e saj si agjitate, propagandiste dhe organizatore kolektive"¹² çka nxjerr në pah dhe rolin e jashtëzakonshëm që kishte shtypi i kohës në ndërtimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të diktaturës. Diktatori Hoxha porosiste të gjithë komunistët se "secili nga ne e ka për detyrë të bashkëpunojë me organet e shtypit"¹³. Në shtyp, sipas diktatorit Hoxha, do mësohej gjithçka rreth ngjarjeve veprimtarive të pushtetit komunist pasi në shtyp "ne japim herë pas here direktiva të cilat duhen zbatuar dhe u duhen bërë të njohura Partisë dhe masave për zbatim, edhe duke vajtur në bazë, edhe duke bërë biseda, por, kur e lyp nevoja, edhe nëpërmjet artikujve dhe konferencave" ¹⁴.

Përfundime

¹⁰ Fuga, Artan, Monolog, faqe 204, Dudaj, Tiranë, 2010

¹¹ Velo, Maks, Esse për Diktaturën Komuniste, faqe 58, 55, Tiranë 2003

¹² Hoxha, Enver, Vepra 24, faqe 332, Mihal Duri, Tiranë 1977

¹³ Hoxha, Enver, Vepra 40, faqe 120, 8 Nëntori, Tiranë 1983

¹⁴ Po aty, faqe 122

Shtypi i shkruar komunist sidomos në vitet 60-70 ku aksioni kundër fesë merr zgjerimin më të madh, shtypi komunist thehet në propagandist kolektiv, agjikator kolektiv dhe organizator kolektiv. Partia komuniste që drejtonte shtetin kishte në dorë të gjitha mekanizmat e pushtetit, përdor shtypin e shkruar kryesisht dhe median në tërësi që të sqarojë vendime e veprime të caktuara politike apo ideologjike. Ideologjia e mediave shqiptare në komunizëm është ideologjia zyrtare e pushtetit që kontrollon gjithçka brenda regjimit totalitar që kishte ndërtuar, ku media padyshim kishte një rol specifik. Detyra e medias në regjimin totalitar shqiptar ishte në organizimin dhe mobilizimin e masave me qëllim mbrojtjen dhe ndërtimin socialist të shqipërisë. Mediat në Shqipërinë totalitare transmetojnë ato informacione dhe të dhëna që janë në përputhje me parimet ideologjike dhe politike të Partisë dhe drejtuesit të Partisë-shtet. Pushteti, mediat e kohës dhe publiku konceptohen dhe funksionojnë si e njëjta gjë, pasi shteti kontrollonte, drejtonte dhe menaxhonte gjithçka. Komunikimet me masën nga media janë përdorur si instrument i shtetit dhe i Partisë, janë të integruar ngushtë me instrumentet e tjerë të pushtetit shtetëror. Shtypi komunist ishte i bashkuar ideologjikisht dhe politikisht i orkestruar në përgjigje direkt ndaj urdhërave politike që vinin nga Komiteti Qëndror. Mediat kontrolloheshin rreptësisht nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, sekretari i komitetit qendror të Partisë për propagandën, shefi i sektorit të shtypit apo drejtori agjitacion-propagandës. Media në regjimin totalitar varet nga grupi i ngushtë i njerëzve që drejton partinë dhe Shtetin me dorë të hekurt. Drejtuesit e sistemit totalitar nëpërmjet medias që vetë kontrollojnë, ata realizojnë propagandën sipas specifikave dhe nevojave të Partisë-shtet dhe tejkrijnë në publik atë informacion që vetë dëshirojnë.

Bibliografia

- Arendt, Hannah, *Origjinat e totalitarizmit*, DIJA, Prishtinë 2002
Fuga, Artan, *Monolog*, Dudaj, Tiranë, 2010

*Shtypi komunist si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin
totalitar shqiptar 1960-1970*

Gazeta “*Bashkimi*” - Organ Qëndror i Frontit Demokratik të Shqipërisë. Monitorim 1960-1970.

Gazeta “*Zëri i Popullit*” - Organ i Komitetit Qëndror të P.P.SH. Monitorim 1960-1970.

Gazeta “*Zëri i Rinisë*” - Organ i Komitetit Qëndror të Bashkimit të Rinisë së Punës së Shqipërisë. Monitorim 1960-1970.

Velo, Maks, *Esse për Diktaturën Komunistë*, 55, Tiranë 2003

Hoxha, Enver, *Vepra 24*, Mihal Duri, Tiranë 1977

Hoxha, Enver, *Vepra 40*, 8 Nëntori, Tiranë 1983

Repishti, Sami, *Nën hijen e Rozafës*, Onufri, Tiranë 2004